



REPUBLIKA E SHOIPERISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2098/2 prot.

Pukë, më 06.01.2024

VENDIM
Nr. 67 datë 27.12.2024

"PËR DHËNIE NË PËRDORIM ME AFAT 10 VJET, SIPERFAQEN PYJORE PREJ 11 HA, PËR QËLLIME PUSHIMI, ARGËTIMI, SHËNDETËSORE, SHOQËRORE, TURISTIKE, SPORTIVE DHE KULTURORE", NE PARCELEN NR.93/A,102/A TE EKONOMISE PYJORE KRRAB-BUSHAT.

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ndryshuar, neni 9, pika 1.2 , germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54 germa e/1, neni 55 pika 3. Ligjit Nr. 57/2020 .Për Pyjet, Vendim.Nr.559, Datë 29.7.2022 Për Përcaktimin E Çmimeve Dhe Tarifave Për Dhënien Në Shfrytëzim/Përdorim Të Fondit Pyjor Kombëtar, Për Veprimtari Ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore, Vendim nr. 433, datë 8.6.2016 Për Transferimin Në Pronësi Të Bashkive rfë Pyjeve Dhe Të Kullotave Publike, Sipas Listave Të Inventarit, Dhe Aktualisht Në Administrim Të Ministrisë Së Mjedisit e Të Ish-Komunave/Bashkive(Per Bashkine Puke Shtojca nr 48). Udhezim Nr. 01.09.2016 "Per Rregullat, Procedurate Kerkimit, te shqyrtimit e Miratimit te Kerkesave Per dhenien ne Perdorim te Fondit Pyjor dhe Kulloror Publik", me propozim të kryetarit të Bashkisë , këshilli Bashkiak mori në shqyrtim dhe pas diskutimit të anëtarëve ;


VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 11 ha " Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive dhe kulturore" në ekonominë pyjore Krrab-Bushat, ngastrën nr. Nr 93/a,102/a me sipërfaqje 11 ha , sipas studimit tekniko-ekonomik bashkelidhur.
2. Afati i dhenies me qira propozohet të jetë 10 vjet.
3. Vlera e dhenies me qira është **1.280.000 leke e përlllogaritur sipas Vendim Nr. 559, Datë 29.7.2022 Për Përcaktimin e Çmimeve Dhe Tarifave Për Dhënien Në Shfrytëzim/Përdorim Të Fondit Pyjor Kombëtar, Për Veprimtari Ekonomike, Si dhe Për Prodhimet Drusore Dhe Jo drusore Pyjore).**
4. Pas miratimit te ketij projekt —vendimi ngarkohet per ndjekje dhe zbatim Drejtoria Menaxhimit te Pyjeve e Kullotave dhe Bujqesise.
5. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe drejtoria pergjegjese per pyjet e kullotat,dhe bujqesine.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen Vendore"
 7. Vendimi u shpall me date 06.01.2025.
- Vota te vlefshme gjithsej : 11
Vota pro 11 , vota kunder 0, vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni



KRYETARI

Gjon GJOKA



H. Terfuri
22.01.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

2025/4
21.01.2025



Nr. 31/1 prot.

Shkodër, më 20.01.2025

Lënda: Mbi Vendimin nr. 67, datë 27.12.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25, pika 1, shkronja "a", të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 50, shtojca 48, të VKM nr. 559, date 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe prodhime drusore dhe jodrusore pyjore", lidhja 1, tabela 6, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", pikat 8 dhe 9, shqyrtoi VKB Pukë nr. 67, datë 27.12.2024 "Për dhënie në përdorim me afat 10 vjet, sipërfaqen pyjore prej 11 ha, për qëllime pushim, argëtimi, shëndetësore, shoqërore, turistikë, sportive dhe kulturore, në parcelën nr. 93/a, 102/a të ekonomisë pyjore Krrab-Bushat", me sipërfaqe 11 ha, të ndarë në ngastrat 93/a në ZK 1586, 102/a në ZK 1586, në ekonominë pyjore "Krrab-Bushat", Bashkia Pukë, ku sipas shkresës së Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër nr. 5865/1 prot., datë 02.12.2024 "Përgjigje shkresës nr. 2115 prot., datë 15.11.2024" dhe shkresës nr. 6456/1 prot., datë 19.12.2024 "Përgjigje e shkresës nr. 2251 prot., datë 11.12.2024" ku këto parcela pyjore rezultojnë pronësi e Bashkisë Pukë
Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Majlinda ANGONI